



PJESË E  KASTRATI GROUP

BUSINESS PROFILE

Përmbajtja

- Informacion rreth Shoqërisë Albsig Sh.a.
- Profili i Shoqërisë Albsig Sh.a.
- Historia e Shoqërisë Albsig Sh.a.
- Qeverisja e Shoqërisë Albsig Sh.a.
- Veprimtaria e Shoqërisë Albsig Sh.a.
- Risigurimi i Portofolit
- Pagesa e dëmeve
- Portofoli i Shoqërisë Albsig Sh.a.



Contents

- Information about Albsig s.a. company
- Company profile
- History of Albsig s.a. company
- Governance of Albsig s.a. company
- Activity of Albsig s.a. company
- Reinsurance of all products portfolio
- Payment of damages
- Products portfolio

INFORMACION RRETH SHOQËRISË SË SIGURIMIT ALBSIG

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor. Albsig ka provigjione teknike të mbuluara me aktive, aftësi paguese mbi nivelin e kërkuar nga ligji, si dhe një kapital 1,851,407,492 Lekë (15.27 milion euro).

“Albsig-Jetë” sh.a., e themeluar nga shoqëria Albsig sh.a. dhe licencuar nga AMF me vendimin 171/2019, ushtron veprimtari sigurimi jete në territorin e Republikës së Shqipërisë prej vitit 2019. “Albsig Jetë” mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor. Albsig ka provigjione teknike të mbuluara me aktive, aftësi paguese mbi nivelin e kërkuar nga ligji, si dhe një kapital 432,254,000 Lekë (3.5 milion euro).

“Albsig Invest” sh.a., e themeluar nga Albsig Jetë, është licencuar në vitin 2019 dhe ushtron aktivitetin si shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. Albsig invest menaxhon Fondin e Pensionit Vullnetar Albsig dhe Fondin e Investimit Albsig Standard. Shoqëria ka kapital 69,000,000 lekë. Albsig Invest ka 377.5 milion lekë asete në administrim, më shume se 3 herë se në vitin pararardhës.

INFORMATION ABOUT THE INSURANCE COMPANY ALBSIG

Albsig s.a. is a non-life insurance company, part of KASTRATI Group, which operates successfully since 2004 in the capacity of non-life insurers, based on financial viability, dedicated and professional staff, quickly and qualitative claim service. Albsig operates through a network of 28 branches covering the territory of Albania. The company has technical provisions, reserves and highest paying ability. The equity of Albsig is ALL 1,851,407,492 (about 15.27 million Euro).

“Albsig-Life” s.a. part of Albsig, operates successfully since 2019 in the capacity of life insurers, based on financial viability, dedicated and professional staff. The company has technical provisions, reserves and highest paying ability. The equity of “Albsig Life” is ALL 432,254,000 Lekë (3.5 milion euro).

“Albsig-Invest” s.a. part of Albsig Life, a managing company licensed by the Financial Supervisor Authority in 2019 for the management of Collective Investment Undertakings. The company manages Albsig Standard investment funds) and Albsig Voluntary Pension Funds. The company has a capital of ALL 69,000,000 and manages assets ALL 377.5 milion .



PROFILI I SHOQËRISË

VIZIONI/ VISION

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.
The customer is our priority. We overcame customer expectations through service, integrity and professionalism.

MISIONI/ MISSION

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.
To be the first choice of any client. We grow together with our customers.

FILOZOFIA/ PHILOSOPHY

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.
To have faith and solidarity with our clients to achieve common success.



ME KLIENTËT NA BASHKOJNË VLERAT:

Besimi e siguria për të përmbushur pritshmëritë e çdo klienti;
Integriteti, sinqeriteti, ndershmëria dhe drejtësia në marrëdhëniet me çdo klient;
Profesionalizmi – përpjekja e pandërprerë për të përmirësuar aftësitë tona dhe për të ofruar shërbime me cilësi të lartë;
Inovacioni – në kërkim të vazhdueshëm për të gjetur mjete e mënyra për të përmirësuar punën dhe forcuar biznesin tonë;
Përballimi i sfidave – sfidave e problemeve nuk u shmangemi, por ofrojmë zgjidhje të drejta e të ndershme.

WE JOIN OUR VALUES WITH CUSTOMERS:

Confidence and security to fulfill the expectations of every client;
Integrity – sincerity, honesty and justice in relationships with each client;
Professionalism – the constant efforts to improve our skills and to provide high quality services;
Innovation – we are constantly looking for ways and means to improve our work and strengthen our business;
Facing Challenges – We do not avoid challenges and problems, but we offer fair and honest solutions to them.



Vlerat që na bashkojnë.

HISTORIKU I SHOQËRISË

Shoqëria e Sigurimeve Albsig sh.a. ushtron veprimtarinë me seli në Tiranë dhe, nëpërmjet 28 degëve, të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë. Përmes një politike tërheqëse dhe stimuluese të Burimeve Njerëzore, Albsig ka angazhuar agjentët e licencuar dhe punonjësit më të mirë në tregun shqiptar të sigurimeve. Mbi 296 punonjës e agjentë dhe një numër i madh bashkëpunëtorësh kontribuojnë në menaxhimin dhe strukturat organizative të Albsig, si dhe një numër i konsiderueshëm janë angazhuar si agjentë në shitje.

Shoqëria është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Tiranë, Vendimi nr. 45, datë 10.09.2004 në cilësinë e siguruesit të jo-jetës (trajtimet e dëmeve). Aktiviteti i sigurimeve zhvillohet nën emrin "ALBSIG" sh.a.


Prej vitit 2019 Albsig ofron produktet e reja të klasës 14 të jo - jetës "sigurimi i kreditit", sigurimin në klasat e jetës si dhe fondet e pensioneve private e investimeve kolektive. "Albsig-Jetë" sh.a. ushtron veprimtari sigurimi të jetës në territorin e Republikës së Shqipërisë prej vitit 2019. Albsig Invest sh.a. ushtron aktivitetin si shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. Albsig invest menaxhon Fondin e Pensionit Vullnetar Albsig dhe Fondin e Investimit Albsig Standard.

COMPANY'S STORY

Albsig s.a. insurance exercises its activity with headquarters in Tirana and, through 28 branches, spread throughout the territory of Albania. Through an attractive and stimulating human resources policy, Albsig s.a. has engaged specialists, licensed agents and employees of service among the best in the Albanian insurance market. Over 296 core employees, agents and many other collaborators contribute in management and organizational structures of Albsig s.a., as well as a significant number are sales agents.

The Company was licensed by the Financial Supervision Authority, Tirana, Decision no. 45, dated 10.09.2004 on the quality of the non-life insurers (damage treatments). The insurance activity in Albania takes place under the name "ALBSIG s.a.

Since 2019, Albsig s.a. offers new non-life insurance products, class 14 "credit insurance", all classes in life insurance and private pension funds and collective investments. "Albsig-Life" provides life insurance products in the territory of the Republic of Albania. Albsig Invest s.a. operates as a Managing Company of Pension Funds and Collective Investment Funds. Albsig Invest manages the Albsig Voluntary Pension Fund and the Albsig Standard Investment Fund.



VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

ALBSIG është i licensuar për të ushtruar aktivitetin në të gjitha klasat e sigurimit të jetës dhe jo jetës. Aktualisht ofron mbi 30 produkte cilësore në tregun shqiptar të sigurimeve. Njëkohësisht ALBSIG sh.a. është prezent edhe në tregun e pensioneve dhe investimeve kolektive. Këto produkte janë asimiluar plotësisht nga klientët.

Aktiviteti i Albsig reflekton një arritje pozitive, si dhe pretendim serioz në fushën e biznesit sigurues. Sipas raportit të fundit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për vitin 2021, Albsig ka rritjen më të madhe të Primeve të Shkruara Bruto me 23.81 % (Primet e Shkruara Bruto ishin 3,327,916,000 Lekë), kur tregu i sigurimeve ka një rritje me 15.40 %. Albsig renditet njëra prej dy shoqërive kryesore të sigurimeve jo-jetë, me 18.69% të tregut të sigurimeve në tërësi, 1.27% më shumë se një vit më parë.

Albsig është e vetmja shoqëri siguri në Shqipëri, ku sigurimet vullnetare përbëjnë më shumë se 53.17 % të portofolit të saj.

Albsig kryeson tregun për Sigurimet Motorrike Vullnetare (Kasko) me 32.62%, Sigurimin e Përgjegjësisë Civile me 46.67 %, Sigurimin e Përgjegjësisë në Ndërtim me 57.14%, Garancitë me 37.64 %. Skema e menaxhimit të Albsig sh.a. bazohet në teknika inovative dhe efikase të menaxhimit të financave. I tërë procesi i shitjes dhe administrimit është i kompjuterizuar, duke mundësuar kontrollin operacional dhe eliminimin e shpërdorimit dhe abuzimeve.

Albsig ka risiguruar portofolin tek risiguruesit më të njohur në botë duke filluar nga Hannover Re (risigurues gjerman lider botëror në risigurime). Albsig Jetë ka risiguruar portofolin tek Swiss Re. Objektivat strategjike të Albsig janë forcimi i mëtejshëm i pozicionit të shoqërisë në tregun shqiptar, rritja e mëtejshme dhe ristrukturimi i portofolit duke i dhënë prioritet produkteve të sigurimit vullnetar, produkteve të jetës, pensioneve private e investimeve kolektive.

Megjithëse me dy vite aktivitet, Shoqëria Albsig-Jetë zë 12.47 % të tregut të sigurimeve të jetës. Ajo është e vetmja shoqëri me rritje 100.05% të primeve të shkruara bruto më shumë se një vit më parë, kur tregu i sigurimeve të jetës ka një rritje me 22.74%.

COMPANY'S ACTIVITY

ALBSIG has launched 30 qualitative products in the Albanian non-life insurance, life insurance and in the Pension Funds and Collective Investment Funds. These products are fully assimilated by the customers.

Albsig current activity reflects a positive achievement, as well as the intention to increase the role of the company in the insurance business. According to the latest report of the Financial Supervisory Authority (FSA) for 2021, Albsig is the only company with increased gross written premiums with an increase of 23.81 % (Gross Written Premiums were ALL 3,327,916 000), when the insurance market has an increase of 15.40 %. Albsig is ranked one of tow leading insurance companies, accounting 18.69% of the Albanian insurance market, 1.27% more than a year ago.

Albsig is the only insurance company in Albania, 53.17% of its portfolio is voluntary insurance.

Albsig leads the market for voluntary motor insurance Casco with 32.62%, Civil Liability Insurance with 46.67%, Construction Liability Insurance with 57.14%, Guarantees insurance with 37.64 %.

Albsig management scheme is based upon new and efficient techniques of finance management. The whole process of selling and administration is computerized, a fact which has enabled operational control and eliminate misuse and abuse.

Albsig has reassured the entire portfolio to the world's best-known reinsurers, with leading reinsurer Hannover RE (German reinsurer, world reinsurer). "Albsig Jetë" has reinsured the portfolio at Swiss Re.

The strategic objectives of Albsig are further strengthening of the company's position in the Albanian market, further growth and change portfolio structure giving priority to the voluntary insurances, life insurance, Voluntary Pension Fund and the Investment Fund.

Although with two years of activity, Albsig-Life Company occupies 12.47 % of the life insurance market. It is the only company with a 100.05% increase in Gross written premiums more than a year ago, when the life insurance market has a increase of 22.74%.





RISIGURIMI I PRODUKTEVE

Kapaciteti teknik e financiar dhe reputacioni i lartë, i ka siguruar Albsig partnerë ndërkombëtarë cilësorë për të risiguruar portofolin e biznesit, për të gjithë produktet e sigurimit.

Albsig risiguron portofolin e Pasurisë, Përgjegjësi, Aksidenteve, Kaskos, DMTPL dhe të Kartonit Jeshil në risiguruesit më të njohur në botë, në partneritet prej 15 vitesh me risigurues kryesor Hannover RE (risigurues gjerman, lider botëror në risigurime) dhe risigurues e brokera të njohur ndërkombëtarisht si: Polish RE, Aon Benfield, MAI, Marsh/Guy Carpenter. Albsig Jetë ka risiguruar portofolin tek Swiss Re.

Partnerët e qëndrueshëm risigurues i garantojnë Albsig pozicion parësor në treg, në aspektin e sigurisë, kapacitetit sigurues pa limit, si dhe dëmshpërblim në kohë rekord, në rast të ndodhjes të çdo lloj rreziku. Risiguruesit e Albsig janë prej vitesh të vlerësuar nga Standard & Poor's (S&P A+), duke mbështetur në mënyrë të vazhdueshme shoqërinë tonë në të gjithë spektrin e produkteve që ofrojmë për të gjithë klientët tanë.

REINSURANCE OF ALL PRODUCTS

The technical and financial capacity, as well as its high reputation, has ensured Albsig important international partners to reinsure the business portfolio for all its insurance products. Albsig reinsures the business portfolio (Property, Liability, Accident, Casco, DMTPL and Green Card) to the world's most renowned reinsurers, in a 15-year partnership with the leading reinsurer Hannover RE (German reinsurer, reinsurance leader) and well-known international reinsurers and brokers such as: Polish RE, Aon Benfield, MAI, Marsh / Guy Carpenter. Albsig "Jetë" has reinsured the portfolio at Swiss Re.

Stable reinsurance partners guarantee Albsig the primary position in the market, in terms of security, unlimited capacity, and very short term indemnification in the event of any kind of risk. For years, Albsig's reinsurers are valued by Standard & Poor's (S & P A +), continuously supporting our society across the spectrum.

PAGESA E DËMEVE

Albsig është leader në tregun shqiptar të sigurimeve për trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim duke ofruar cilësi, shpejtësi dhe standarte të larta. Albsig ka trajtuar dhe paguar dëmet e shkaktuara nga ngjarjet e tërmetit të vitit 2019 brenda vitit 2020.

Sipas AMF, në vitin 2021 Albsig ka paguar 873,114 000 lekë dëmshpërblim, 14.41% të të gjitha dëmeve në tregun e sigurimeve.

Kërkesat për dëmshpërblim janë paguar në më pak se gjysmën e periudhës ligjore, me marrëveshje, pa kontestime nga kërkuuesit.

Albsig vazhdon të jetë shoqëria me numrin më të vogël të dëmeve pezull në tregun e sigurimeve për vitin 2021 duke i ulur me 46% këto dëme krahasuar me vitin 2020.

Për të gjithë praktikantët e dëmeve të trajtuara në vitin 2021 nuk ka asnjë ankesë në AMF dhe vetëm 4 çështje gjyqësore.

PAYMENT OF DAMAGE

Albsig is leader in the Albanian insurance market to handle claims for damages for compensation by offering high quality, speed and standards. Albsig has treated and paid the damages caused by the earthquakes of 2019 within year 2020. According to AFSA, for 2021 Albsig has paid a total ALL 873,114 000 in damages, 14.41% of all claims in the Albanian insurance market. Claims for damages are paid in less than half of the legal period, by agreement, without contestation by the claimants.

Albsig continues to be the company with the smallest number of pending claims in the Albanian insurance market for 2021, reducing these pending claims by 46% compared to 2020.

For all damages practices in 2021 there are no complaints to the FSA and only 4 litigation cases.





KONTRAT E SIGURIMIT JO-JETËS

Albsig Sh.a. operon aktualisht ne partneritet me shumë insitucione të sektorit tregtar, financiar e bankar, duke ofruar mbulim në sigurim të risqeve të klienteve të këtyre institucioneve si dhe ofrimin e produkte të dizenuara posaçërisht sipas nevojave të klientëve. Në përputhje me legjislacionin dhe kuadrin e liçensimit, aktiviteti i Albsig Sh.a. ushtron dhe përfshin grupet e sigurimit të listuara në këtë faqe.



Grupi Nr. 1: SIGURIMI I AKSIDENTEVE

Sigurimin i aksidenteteve personale dhe kolektive përcakton çdo ngjarje të papritur dhe të paparashikuar, që ndodh në mënyrë rastësore pa vullnetin e të siguruarit.



Grupi Nr. 2: SIGURIMI I SHËNDETIT

Sigurimin e shëndetit mbulon një shpërndarje të gjerë të rreziqeve që lidhen me sëmundje të ndryshme të individëve / kolektive.



Grupi Nr. 3: SIGURIMI "KASKO"

Sigurimi Kasko mbulon humbjet apo dëmtimet e pjesshme ose të plota të mjetit të siguruar ndaj rreziqeve në sigurim.



Grupi Nr. 4: SIGURIMI I "MJETEVE LËVIZËSE"

Ofron sigurimit për mjetet që lëvizin mbi shina.



Grupi Nr. 5: SIGURIMI I "AVIONEVE"

Ky sigurim mbulon humbjen e vetë mjetit fluturues, mbulon humbjet e palëve të treta (përveç pasagjereve) si dhe përgjegjësinë ndaj pasagjereve.



Grupi Nr. 6: SIGURIMI I "ANIJEVE"

Sigurimi i Mjeteve Lundruese (Hull) mbulon rreziqet ndaj të cilave mjeti i siguruar, mund të hasi gjatë lundrimit.



Grupi Nr. 7: SIGURIMI I "MALLRAVE NË TRANSPORT"

Sigurimi i mallrave gjatë transportit mbulon humbjet dhe dëmet që pësojnë mallrat gjatë transportimit të tyre, të destinuara për tu tregtuar, ose transferuar në pronarë të rinj.



Grupi Nr. 8: SIGURIMI NGA "ZJARRI DHE FORCAT E NATYRËS"

Ky sigurim mbulon humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar apo aksidentale



Grupi Nr. 9: SIGURIMI I "DËMTIMEVE TË TJERA NË PRONË"

Sigurimi i të gjitha objekteve të kualifikuar si "pasuri e patundshme" dhe përmbytjen e tyre të poseduara nga pronari ose në favor të bankave dhe bizneseve.



Grupi Nr. 10: SIGURIMI I "PËRGJEGJËSISË MOTORRIKE NDAJ PALËVE TË TRETA"

Sigurimi i mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme) është një sigurim i detyrueshëm dhe i ofrohet mbajtësit të mjetit motorik, që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.



Grupi Nr. 11: SIGURIMI I "PËRGJEGJËSIVE CIVILE TË AVIONËVE"

Sigurimi i marrjes së përgjegjësisë të palëve të treta në rast të dëmtimit gjatë përdorimit të avionëve.



Grupi Nr. 12: SIGURIMI I "PËRGJEGJËSIVE CIVILE TË ANIJEVE"

Sigurimi i marrjes së përgjegjësisë të palëve të treta në rast të dëmtimit gjatë përdorimit të anijeve.



Grupi Nr. 13: SIGURIMI I "PËRGJEGJËSIVE CIVILE TË PERGJITHSHME"

Sigurimi i përgjegjësisë civile të përgjithshme, përgjegjësi publike të produktit për dëmtimin e pronës dhe shëndetit të palëve të treta, etj.



Grupi Nr. 14: SIGURIMI I "KREDITIT"

Sigurimi i Kreditit mbulon rreziqet e paafësisë paguese dhe mospërbushjes së detyrimeve financiare.



Grupi Nr. 15: SIGURIMI I "GARANCIVE"

Sigurimi i Garancive ofron mbulim financiar për biznesin tuaj përpara autoritetit kontraktues.



CONTRACT OF INSURANCE NON-LIFE

Albsig s.a. operates in partnership with institutions to obtain more commercial, financial and banking, offering insurance coverage to clients of the risks of these institutions and also by offering products specifically designed for the needs of clients. In compliance with legislation and licensing framework, "Albsig" activity is extended and includes the insurance groups as listed.



Group Nr. 1: ACCIDENTS

Insurance of personal and collective accidents of any unexpected and unforeseen event, which happens accidentally without the will of the insured



Group Nr. 2: HEALTH INSURANCE

Health insurance covers a wide range of risks associated with various individual / collective diseases



Group Nr. 3: CASCO

Casco insurance covers partial or complete losses or damages of the insured vehicle against insurance risks.



Group Nr. 4: VEHICLES MOVING ON RAILS

Provides insurance for the vehicles moving on rails.



Group Nr. 5: AIRCRAFT

This insurance covers the loss of the aircraft itself, covers the losses of third parties (other than passengers) as well as liability to passengers.



Group Nr. 6: SHIPS

Hull Insurance covers the risks that the insured vehicle may encounter while sailing.



Group Nr. 7: GOODS BEING TRANSPORTED

Insurance of goods during transport covers losses and damages suffered by goods during their transport, intended to be traded, or transferred to new owners.



Group Nr. 8: FIRE AND NATURAL DISASTERS

This insurance covers the loss, damage or destruction of property insured unexpectedly, unforeseen or accidentally.



Group Nr. 9: OTHER DAMAGE TO PROPERTY

Securing all objects qualified as "real estate" and their content owned by the owner or in favor of banks and businesses.



Group Nr. 10: CIVIL RESPONSIBILITY OF THE USE OF VEHICLES

Motor vehicle liability insurance (internal MTPL) is a compulsory insurance and is offered to the holder of the motor vehicle, circulating within the territory of the Republic of Albania.



Group Nr. 11: RESPONSIBILITIES OF USING CIVIL AIRCRAFT

Ensuring liability of third parties in the event of damage during the use of aircraft.



Group Nr. 12: CIVIL RESPONSIBILITY OF THE USE OF SHIPS

Ensuring third party liability is taken in the event of damage during the use of the vessels.



Group Nr. 13: GENERAL CIVIL RESPONSIBILITIES

Insurance of general civil liability, public liability of the product for damage to property and health of third parties, etc.



Group Nr. 14: INSURANCE OF CREDIT

Credit insurance covers the risks of insolvency and default.



Group Nr. 15: GUARANTEES

Guarantee Insurance provides financial coverage for your business before the contracting authority.



PORTOFOL SIGURIMI

PORTOFOLI I SIGURIMEVE / PRODUKTEVE

- Sigurimi i shëndetit dhe aksidenteve
- Sigurimi i mjeteve motorike
- Sigurimi i pasurisë
- Sigurimi i garancive
- Sigurimi i përgjegjësi
- Sigurimet inxhinierike
- Sigurimi i mjeteve lundruese, fluturuese dhe mallit gjatë transportit
- Sigurimi i mjeteve monetare dhe bankës

INSURANCE PORTFOLIO / PRODUCTS

- Health and accidents insurance
- Motor vehicles insurance
- Property insurance
- Guarantees insurance
- Liability insurance
- Engineering insurance
- Vessels, aircraft and goods during transport.
- Cash and bank insurance

SIGURIMI I SHËNDETIT DHE AKSIDENTIVE

SIGURIMI I SHËNDETIT NË UDHËTIM.

SIGURIMI NGA AKSIDENTET PERSONALE/KOLEKTIVE.

SIGURIMI I NXËNËSVE DHE STUDENTËVE.

PAKETAT E SIGURIMIT TË SHËNDETIT.

Sigurimi i shëndetit në udhëtim i ofrohet çdo qytetari Shqiptar, që udhëton jashtë territorit të Shqipërisë. Ai mbulon humbjet e ndodhura që mund të lindin nga aksidente të ndryshme, ndërhyrjet mjekësore nga sëmundje akute, si dhe shpenzimet e riadhesimit në rast sëmundje, apo të humbjes së jetës, brenda periudhës së sigurimit për gjatë gjithë periudhës së qëndrimit jashtë territorit të Shqipërisë.

Sigurimi nga Aksidentet Personale i ofrohet çdo personi që paraqet kërkesën për t'u siguruar, pavarësisht moshës, veprimtarisë profesionale, etj. Ai mbulon dhe dëmshpërblen, në rast se i siguruari pëson dëmtime shëndetësore si:

- Paaftësinë e përkohëshme
- Paaftësinë e përhershme, ose
- Humbjen e jetës

Dëmtime të cilat mund të lindin nga ngjarje aksidentale, të papritura, të paparashikuara, të dhunshme, që veprojnë nga jashtë dhe që shkaktojnë dëmtime fizike që janë objektivist të vërtetueshme.

Sigurimi i Nxënësve dhe Studentëve i ofrohet çdo nxënësi, studenti apo institucioni arsimor. Ai mbulon humbjet e ndodhura që mund të lindin nga aksidente të ndryshme dhe shpenzimet shëndetësore si:

- Paaftësinë e përkohëshme;
- Paaftësinë e përhershme, ose
- Humbjen e jetës

Dëmtime të cilat mund të lindin nga ngjarje aksidentale, të papritura, të paparashikuara, të dhunshme, dhe që shkaktojnë dëmtime fizike që janë objektivist të vërtetueshme.





Paketat e Sigurimit të Shëndetit ofrohen për punëmarrësit, familjarët, fëmijët, etj. Ajo mbulon shpenzimet mjekësore në rast sëmundjesh dhe problemesh shëndetësore. Paketat mundësojnë trajtimin në entet spitalore dhe diagnostikuese më të specializuara. Duke paraqitur kartën e sigurimit të "ALBSIG" SH.A. të siguarit përfitojnë trajtime preferenciale për çdo rast të domosdoshëm shëndetësor, sipas paketës së sigurimit të përzgjedhur nga klienti.

Sigurimi i shëndetit bazik ka 3 paketa të fashës ekonomike.

- **Albsig Ekonomik** ofron check up dhe mbulim për shërbimet ambulatorë, përfitim në rast aksidenti deri në shumën 10,000 euro në vit (shërbimet në të gjithë rrjetin spitalor privat në Shqipëri).
- **Albsig Baze** ofron check up dhe shërbime më të kualifikuara, përfitim në rast aksidenti deri në shumën 20.000 euro në vit (shërbimet në të gjithë rrjetin spitalor privat në Shqipëri).
- **Albsig Standarte** është paketë individuale dhe po kështu dhe sigurim familjar. Paketa standart ofron check up të plotë vjetor me 12 shërbime kualitative dhe përfitim në rast aksidenti deri në shumën 25.000 euro në vit.

Kategoria premium ka paketat si më poshtë:

- **Albsig Superior** (30,000 Euro) kompenson vizitat mjekësore dhe analizat përkatëse, trajtimet e lehta ambulatorë, vizitat dhe diagnostikimet onkologjike, shërbimet mjekësore pas daljes nga spitali.
- **Albsig Silver** (50,000 Euro) kompenson trajtimin spitalor në tërësi si proces, i cili përfshin akomodimin spitalor, ushqimin, barnat, pagesat për kirurgun, anestezistin, sallën e operacionit, njësine e kurimit intensiv, rezonanca manjetike, etj.

HEALTH AND ACCIDENT INSURANCE

TRAVEL HEALTH INSURANCE.

PERSONAL/COLLECTIVE ACCIDENTS INSURANCE.

STUDENT INSURANCE.

HEALTH INSURANCE PACKAGE.

Travel health insurance is offered to every Albanian citizen, traveling outside the territory of Albania. This insurance covers losses incurred caused by different accidents, medical intervention of acute illness, and the costs of repatriation in case of illness or loss of life, within the period of insurance for the entire period of residence outside the territory of Albania.

Personal /Collective Accident insurance is offered to any person who is applying to be secured, regardless of age, professional, etc.

This insurance provides coverage and indemnification in case the insured suffers health damage such as:

- Temporary Disability
- Permanent Disability or
- Loss of life.


Damage which may arise from accidental events, unexpected, unforeseen, violent, operating from abroad and causing physical injuries that are objectively verifiable.

Insurance of pupils and students is offered to every student and educational institutions that request to be insured. This insurance covers incurred losses that may arise from various accidents and medical expenses as:

- Temporary Disability
- Permanent Disability or
- Loss of life

Damage which may arise from accidental events, unexpected, unforeseen, violent, operating from abroad and causing physical injuries that are objectively verifiable.





Health packs "ALBSIG" JSC "Insurance of disease" is offered to all, employees, families, children etc. "ALBSIG" health packs provide hospital treatment and more specialized diagnostic and abroad Republic of Albania. Just presenting insurance card "ALBSIG" JSC you get preferential treatment for any health case if necessary. Sickness insurance is offered under the insurance package selected by the customer.

Basic health insurance packages containing 3 economic bandage:

- **Albsig Economic** covers partial check up, benefits amounting to 10,000 euro per year. (services in the private hospital network in Albania).
- **Albsig Basic** offers partial, check up and the most qualified services in case of accident benefit amounting to 20 000 euro per year (services in the private hospital network in Albania).
- **Albsig Standard** is both as a individual package and for family and offers annual check up complete with 12 quality services and benefits in case of accident amounting to 25,000 euros per year (services in the private hospital network in Albania).

Premium health insurance packages are as follows:

- **Albsig Superior** (30,000 Euro) compensates for medical visits and appropriate tests, light treatments outpatient visits and diagnostics oncology, medical services after discharge.
- **Albsig Silver** (50,000 Euro) compensates in general hospital treatment process, which includes hospital accommodation, food, medicines, fees for the surgeon, anesthetist, operating room, intensive care unit, magnetic resonance, etc.



SIGURIMI I MJETEVE MOTORIKE

SIGURIMI KASKO.

SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË NDAJ PALËVE TË TRETA (MTPL).

SIGURIMI KUFITAR I MJETIT MOTORRIK.

SIGURIMI I KARTONIT JESHIL I MJETIT MOTORRIK

SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË SË PASAGJERIT

Sigurimi Kasko mbulon humbjet apo dëmtimet e pjeshme ose të plota të mjetit të siguruar ndaj rreziqeve në sigurim. Sipas paketave sigurimi kasko mbulon:

- Dëmtimet Aksidentale;
- Dëmtimet në parkim pa autor;
- Thyerja e xhamave;
- Zjarri, eksplozioni dhe rrufeja;
- Katastrofat natyrore (stuhia, breshëri, dëbora, përmbytja, etj.);
- Vjedhja e plotë e mjetit;
- Vjedhja e Pjeshme e mjetit (aksesorët);
- Shërbim Karroatreci;
- Shërbim GPS;
- Shtrirja e mbulimeve në territorin Europian;

Sigurimi i mjetit motorrik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme) është sigurim i detyrueshëm dhe i ofrohet mbajtësit të mjetit motorrik, që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Siguruesi merr përsipër përgjegjësinë Civile të të Siguruarit, ndaj palëve të treta, kur ai përfshihet në një aksident dhe është përgjegjës për dëme materiale, pasurore dhe/apo shëndetësore, në bazë të Ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

Sigurimi kufitar i mjetit motorrik është sigurim i detyrueshëm dhe i ofrohet mbajtësit të mjetit motorrik me targa të huaja, që qarkullon brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Albsig sh.a. merr përsipër përgjegjësinë civile të të Siguruarit, ndaj palëve të treta, kur ai përfshihet në një aksident dhe është përgjegjës për dëme materiale, pasurore dhe/apo shëndetësore.

Sigurim Karton Jeshil është sigurim i detyrueshëm dhe i ofrohet mbajtësit të mjetit motorrik, që qarkullon jashtë territorit të Shqipërisë, në një nga vendet anëtare të keshillit të Byrove, por që janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë. Kjo policë sigurimi ju mbron Ju dhe automjetin tuaj nga dëmet (materiale dhe jo materiale), që u shkaktohet palëve të treta në rast aksidenti, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

